



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 15.06.2022

**VENDIM**

Nr. 08 datë 15/06/2022

**“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 ”Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

**VENDOSI:**

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
  - Josif Perikli Mिंगa, lindur në Korçë më 14.06.1953
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT**

**ANA VERUSHI**



Konceptoi: Gjergji Kristo  
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

**Për Përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror**

**Për Z. Josif Minga**

Në datën 01.06.2022, pranë Këshillin e Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa e z. Josif Minga për ti propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rrezulton se kërkuesi i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Date 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

Josif Perikli Minga, ka lindur në Korçë më 14.06.1953, ku ka shfaqur që i vogël prirjet muzikore ku është vlerësuar 3 herë me vendin e parë si fizarmoniçist. Ka mbaruar shkollën e mesme “Themistokli Gërmenji” në vitin 1971 dhe ka vijuar studimet e larta në Institutin e Lartë të Arteve në degën Teori-Kompozim të cilat i ka përfunduar në vitin 1976. Për 13 vjet ka qenë mësues i lëndëve artistike në shkollën e mesme artistike “Tefta Tashko Koço” në Korçë. Është zgjedhur anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve Artistëve të Shqipërisë dhe nga viti 1976 e në vazhdim, sekretar i muzikës për degën e Korçës. Nga viti 1987-1993 ka punuar si profesionist, kompozitor i caktuar nga kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve Artistëve Tiranë dhe nga viti 1994 ka filluar si pedagog i lëndëve edukim artistik, filozofi arti dhe trashëgimi kulturore në ciklin e parë dhe Master. Është specializuar në Itali, Angli, Belgjikë me bursa Tempus dhe në vitin 2002 ka marrë titullin “Profesor i asociuar”, ndërsa në 30 tetor të 2022 ka dalë në pension. Kontributi i z. Josif Minga është shumë i pasur dhe me një shtrirje të gjatë në periudhë kohore ku mund të përmendim:

- Ka qenë udhëheqës artistik në 22 Festivale Folklorike në qytete të ndryshme ku 8 herë është nderuar me çmim të parë.

- Udhëheqës artistik i Ansamblit Folklorik “Skënderbeu” prej vitit 1979 e në vazhdim me 28 shfaqje dhe përfaqësime jashtë shtetit.
- Udhëheqës artistik në 32 takime, festivale, konkurime ansamblesh muzikore e estradash që prej viti 1975.
- Koordinator për Korçën i projektit kulturor “ Qytetet krijuese”, 2008-2011 mbështetur nga Swiss Cultural Programme.
- Koordinator për Korçën i Festivalit European të Koreve, 2006-2008.
- 24 pjesëmarrje në juri, stafe drejtimi të spektakleve televizive etj.

Ndër aktivitetet kryesore krijuese me verat e ekzekutuara brenda dhe jashtë vendit mund të përmendim:

- Pjesëmarrës në festivalin e 11-të të Këngës në RTSH (me këngëtarët V.Zela, A. Hisku, T.Tërshana, Sh.Merdani etj). Në festivale të muzikës së lehtë në rrethe, në festivale për fëmijë e popullore (me këngët “Kitaristët Korçarë”, “Bie po s’dua të fle”, “Si Agimi i kuq” etj). Me muzika skenike, Muzikë filmi , vepra orkestrale, rapsodi shqiptare, si për unues i 180 këngëve popullore qytetare si dhe krijime origjinale, ku spikatin edhe kompozimet e himneve të shkollave të mesme të qytetit.

Si pjesëmarrës në aktivitete ndërkombëtare mund të përmendim:

- Prezantimin e Iso-polifonisë shqiptare në Itali, Greqi, Bullgari, Austri, Kroaci nga 1975 e në vazhdim, Kongresin Botëror të Unescos, Bullgari. Cioff International (2006), panaiet artistike Itali- Udine 2007-2009, Fest interfolk 44 Zagreb -Kroaci 2010, Shkolla verore, Tradizioni popolari tricase, Itali korrik 2021.

Është anëtar i këshillit botues të revistës “Iso-Polifonia”, anëtar i Filarmonisë së Korinthit, Greqi, anëtar i këshillit të kulturës në Bashkinë e Korçës, nënkryetar i shoqatës artistike-kulturne “Iliria” sekretar i CIOFF për Shqipërinë.

Gjatë karrierës së tij të gjatë ai është vlerësuar me shumë urdhëra, medalje e tituj, ndër të cilët mund të përmendim:

- Çertifikatën e projektit “Step by step”, viti 1999
- Titulli “Profesor i Asociuar”, Universiteti “Fan.S.Noli”, datë 22.04.2003
- Vlerësim nga TV-KLAN: 100 Këngët e shekullit viti 2005
- Titulli: “Nderi i Qarkut Gjirokastër”, Gjirokastër 08.05.2006
- Emblema e Bashkisë së Korinthit, viti 2014
- Çertifikatë “Mirënjohjeje” Universiteti “Fan.S.Noli” 18.11.2016.
- Titulli “Mjeshtër i Madh”, Tiranë 31.05.2018

Z. Josif Minga i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë".

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkuesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe çertifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 "Per kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore".

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ANAVERUSHI**

Konc. Gj. Kristo

